



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:142323
Datë: 20.06.2024
Numri i dokumentit: 05838588

K.Dh.Shk.II.nr.771/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit ARFA Group Sh.P.K., me seli në Deçan, fshati Sllup, me autorizim e përfaqëson Burhan Shabanaj, avokat nga Peja, kundër debitorit Komuna e Pejës, me autorizim e përfaqëson Drita Sopi Gashi, avokate nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1501/23 të datës 15.01.2024, me datë 19.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e bazuar ankesën e kreditorit ARFA Group Sh.P.K., me seli në Decan, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1501/23 të datës 15.01.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1501/23 të datës 15.01.2024, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Pejës, kundër urdhrin përmbartimor P.nr.169/21, të datës

16.06.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Shpend Ahmetaj të cilën anulohet, në pikën II shpenzimet e përfaqësimi në seancën dëgjimore të mbajtur pranë kësaj Gjykatë i bartë secila palë veç e veç.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori ARFA Group Sh.P.K., me seli në Deçan, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1501/23 të datës 15.01.2024, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit, duke e shfuqizuar Urdhrin për Përmbarim P.nr.169/21, të datës 16.06.2021 si dhe të anulohet aktvendimi KPPP.nr.1501/23 të datës 15.01.2024, Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë dhe të kthehet lënda në rivendosje.

Përgjigje në ankesa ka parashtruar debitori, duke propozuar që të refuzohet ankesa e kreditorit si e pa bazuar dhe aktvendimi ankimor KPPP.nr.1501/23 të datës 15.01.2024 të vërtetohet si i bazuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ARFA Group Sh.P.K., me seli në Deçan, me datën 10.11.2027 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbarimit, kundër debitorit Komuna e Pejës, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës për shumën e borxhit prej 16,935.00 €.

Përmbaruesi Privat Shpend Ahmetaj me seli në Gjilan, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.169/21, të datës 16.06.2021, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës nr.00060/18 të datës 05.09.2018, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumën prej 16,935.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e pranimit të urdhërin e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ

UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbarrimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbarrimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbarrimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1501/23 të datës 15.01.2024, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Komuna e Pejës, kundër urdhrin përmbarrimor P.nr.169/21, të datës 16.06.2021, të lejuar nga Përmbarruesi Privat Shpend Ahmetaj të cilën anulohet, në pikën II shpenzimet e përfaqësimi në seancën dëgjimore të mbajtur pranë kësaj Gjykatë i bartë secila palë veç e veç.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata duke i shqyrtuar të pretendimet, në bazë të shkresave të lëndës dhe në bazë të vërejtjeve të Aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë Kom.Dh.Shk.II.nr.520/23 të datës 10.05.2023, ka theksuar se në rastin konkret propozimi për përmbarrim nuk i përmbanë të gjitha elementet e parapara nga LPP-ja, më konkretisht faturat si dokument i besueshëm rezultojnë se nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 par. 1 nën para. 1.3 të LPP-së ku përcakton se: *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm dhe dokument i besueshëm sipas këtij ligji është fatura”*, ndërsa neni 29 par. 3 të LPP-së thuhet se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Kurse me nenin 37 të LPP-së përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë dokumenti - Faturat, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbarrim, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për faktin se faturat në rastin konkret nuk përmbanë kohën e përmbushjes së detyrimit monetar, si një nga elementet kumulative, gjithashtu debitori brenda afatit të dhënë nga kreditori prej 7 ditësh, ka kundërshtuar sa i përket ekzekutimit të kësaj fature, përmes

komunikimit të datës 09.06.2021, pra është kundërshtuar brenda afatit vullnetar të përcaktuar nga vet kreditori dhe për këtë shkak kreditori nuk mund të thirret se debitori e ka pranuar faturën në mënyrë të rregullte së bashku me detyrimin që buron nga kjo faturë. Andaj, duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, si e tilla të njëjtat mund të shërbejnë si dokumente të besueshme dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelle thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes për pranimit të prapësimin të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se faturat e lëshuara nga ana e kreditorit nuk i përmban përmbanë kohën e përmbushjes së detyrimit monetar dhe nga ana tjetër është kundërshtuar nga debitori me rastin e ri dërgimit të kësaj fature, brenda afatit vullnetar të përcaktuar nga vet kreditori. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 i LPP, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Ndërsa sipas nenit 37 të LPP-së përcakton *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se fatura si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbarimore, respektivisht është lejuar përmbarimi nuk i plotësojnë kushtet në mënyrë kumulative që duhet t’i ketë dokumenti i besueshëm. Në rastin konkret qartë rezulton se faturat nuk e përmbajnë kohën e përmbushjes së detyrimit monetar si një nga elementet kumulativ të përcaktuar me nenin 29 par 3 të LPP-së, po ashtu me rastin e ridërgimit të kësaj fature nga

kreditori përmesë komunikimit elektronik të datës 04.06.2021 kreditori i ka dhënë afat debitorit për përmbushje e kësaj fature brenda 7 ditëve nga pranimi i saj ndërsa debitori ka kundërshtuar sa i përket ekzekutimit të kësaj fature brenda afatit përmesë komunikimit elektronik datës 09.06.2021, andaj fatura në fjalë nuk i ka tiparët e përmbarushmërisë dhe nuk është e përshtatshme për përmbarim pasi që ky kundërshtim është ngritur nga debitori brenda afatit vullnetar për pagesë të caktuar nga vet kreditori. Kështu edhe kjo gjykatë vlerëson njëjtë se kreditori nuk mund të thirret se debitori ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e lartëcekur së bashku me detyrimin që buron nga kjo faturë, kjo pasi që me rastin e dorëzimit të faturës në arkivin e kreditorit dhe paisjes së saj me vulë e prtokullit, kjo faturë nuk ka përmbatjur afat pagesë brenda të cilit afat, debitori eventualisht ka mundur ta kundërshtoj të njëjtën. Andaj në procedurën e përmbarimit shyrtohet vetëm përshtatshmëria e dokumentit përmbarues dhe jo ligjshmëria e cila i ka paraprirë të njëjtit, por që në rastin konkret rezulton se fatura në fjalë i mungon pranimit nga ana e debitorit ngase e njejta është kundërshtuar brenda afatit vullnetar për pagesë të përcaktuar nga kreditori.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë i vlerësoj pretendimet ankimore po që i refuzoj si të pa bazuar për shkak se nuk kishin ndikim në një vendim ndryshe në këtë çështje përmbarimore. Andaj gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimi se në procedurën përmbarimore organi përmbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përmbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e shkallës së dytë
K.Dh.Shk.II.nr.771/24 dt. 19.06.2024

Gjyqtarja
Franciska Zhitija Ymeri